

në Rahovec/Orahovac. E respektonin shqiptarë dhe serbë. Gjatë kohës së pushtetit komunist, ka qenë i dënuar për shkak të veprimtarisë politike. Hasani ishte gardian dhe shërbyes në Teqenë e Qytetit nga viti 1975. Jetonte me bashkëshorten Ajshen në një shtëpi në lagjen *Strana*, ndërkaq djemtë e tij jetonin në shtëpitë e veta në të njëjtën lagje.

Në datën 20.07.1998, në orët e hershme të mëngjesit, policia i ka përzënë nga Teqeja qytetarët që u strehuan atje [të shikohen regjistrimet]. Por, Shehu Muhedin dhe Hasani ndenjen në Teqenë. Trupin e pajetë të Hasanit të vrarë e kanë gjetur në oborrin e Teqesë Samedin dhe Kadrushe Ejupi, më **21.07.1998 [Rahovec/Orahovac]**. E kishin qëlluar me dy plumba në kokë dhe me një tjetër në qafë. E bartën trupin e Hasanit në shtëpinë e Avdyl Shehut. Nga kjo shtëpi, policët e çuan trupin e Hasanit në drejtim të panjohur.

Shehun Muhedin e kanë vrarë më **22.07.1998**. E kanë varrosur në oborrin e Teqesë. Nëntë muaj më vonë, në muajin maj të vitit 2007, familjarët e Hasanit mësuan se ishin identifikuar mbetjet e tij mortore, që ishin të varrosura në një gropë bërriloku [prapa varrezave myslimane] në Rahovec/Orahovac. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Hasanit më 12.09.2007, në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata B.D, FDH-428; deklarata N.N, FDH-852; deklarata Xh.B, FDH-863; deklarata G.S, FDH-881; deklarata N.N, FDH-882; deklarata D.H, FDH-926; deklarata M.S, FDH-969; LBI, *Preliminar...*, FDH-3631; deklarata Z.G, FDH-18940; V.B, FDH-20095; deklarata N.N, FDH-20102; deklarata A.LI, FDH-35284; deklarata H.K, FDH-35289.

Musa (Qazim) Kadiri

(1937, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, elektrikist, tetë fëmijë)

Musa me bashkëshorten Hilmijen kanë jetuar në shtëpinë familjare në rrugën *Miladin Popović*, te Stacioni i Autobusëve në dalje të qytetit [**Rahovec/Orahovac**], në drejtim të fashit Xërxë/Zrze. Me ta në bashkësi familjare jetonin djemtë

Mifteremi, Qazimi, Bashkimi, Ademi dhe Feimi me familjet e veta, përderisa vajzat Sadetja, Myrvetja dhe Drita kanë qenë të martuara. Djemtë me familjet e tyre e kanë braktisur qytetin më 17.07.1998. Shkuan në Dragobil/Dragobilje. Një ditë më vonë, djemtë u kthyen që t'i merrnin Musën dhe Hilmijen, por ata vendosën të rrinin në shtëpi. Në datën **22.07.1998**, nga ora 3:00 të mëngjesit, një grup i policëve serb ka hyrë në shtëpinë e Musës. I kanë urdhëruar Musës që me Hilmijen të braktisnin qytetin. Sapo dolën në rrugë, një grup tjetër i policëve, i cili qëndronte afro 20 metra larg nga Stacioni i Autobusëve, hapi zjarr ndaj qiftit bashkëshortor Kadiri. Musën e kanë qëlluar në stomak dhe në gjoks, përderisa Hilmijen në këmbë dhe në dorë. Një djalosh i ka bartur që të dy me një qerre të vogël deri te Stacioni i Autobusëve, nga ky policia me një kamion dhe me burra të tjerë i ka transportuar në Prizren. Musën dhe Hilmijen i kanë dërguar në spital, ndërkaq burrat në SHPB-në e qytetit. Më pas, Musën e dërguan në spitalin e Prishtinës/Priština. Atje, ai ka ndërruar jetë nga plagët vdekjeprurëse më 29.07.1998. Një mik i familjes e ka marr trupin e Musës dhe e ka varrosur në varrezat e qytetit në Prishtinë/Priština. Pas lufte, më 30.07.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Musës në varrezat e Rahovecit/Orahovac.

Burimet: dekarata N.N, FDH-872; dekarata N.N, FDH-876; dekarata A.S, FDH-2100; dekarata V.M, FDH-2107; dekarata S.S, FDH-2108; dekarata M.K, FDH-38183; *Albanian, Wounded in Rahovec, Dies in Prishtina Hospital*, pasqyra e lajmeve, KIC, 04.08.1998, FDH-29391.

Ramadan (Brahim) Morina

(27.11.1957, shqiptar nga Qypeva/Čupevo, komuna e Malishevës/Mališevo, arsimtar, tetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Ramadani me bashkëshorten dhe fëmijët jetonin në bashkësi familjare me familjen e të vëllait Avdyllit. Ai punonte si arsimtar në shkollën fillore në fshatin Damanek/Domanek [Glllogoc/Glogovac]. I ishte bashkëngjitur shtabit lokal të UÇK-së në